



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.05.2015** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi – Më lejoni të përshëndes Nënkryetarin komunës z. Xhemali Haxhimustafa dhe stafin e tij, delegatët e pranishëm në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, monitoruesin e KDI-së, drejtorin e shkollës “Ardhmëria” me nxënës, përfaqësuesit e mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Për mbledhjen e sotme propozoj këtë:

Rend Dite

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,**
3. **Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën Janar-Mars 2015,**
4. **Shqyrtimi i projekt Vendimit për formimin e Komisionit ad – hoc për shqyrtimin e ankesave të studentëve për bursa,**
5. **Propozimi i anëtarëve për formimin e komiteteve jo obligative.**

Rukije Krasniqi – Propozoj që si pikë e rendit të ditës të futet edhe raportimi i punës së komisionit për formimin e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane. Besoj se kryesuesi i komisionit Rasim Fazliu është gati për të raportuar dhe nëse nuk është e mundur për këtë mbledhje propozoj që në mbledhjen e ardhshme ta kemi këtë pik si rend dite.

Rasim Fazliu – Faleminderit për propozimin por unë e them këtu se unë nuk raportoj deri sa nuk bëhet pagesa e komisionit.

Fatmir Iska – Kam një vërejtje të vogël për kryesuesin e Kuvendit për vonesën prej 15 min në seancën e kuvendit komunal. Po ashtu kam një propozim që të mbahet 1 minutë heshtje për të rënë në Kumanovë.

Kryesuesi - Besoj se rekomandimet i keni në material nga KPF, e qesë në aprovim rendin e ditës: Konstatohet që në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.** Procesverbali nga mbledhja e kaluar aprovohet pa vërejtje.

Përparim Krasniqi – Kërkoj që të mbahet 1 minutë heshtje për të rënë në gjithë trojet shqiptare dhe po ashtu për ata dëshmorë që ranë së fundmi në Kumanovë.

2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**

Kryesuesi - Shërbimi i Kuvendit gjitha pyetjet që ju i keni parashtruar këtu në Kuvend ju ka dërguar drejtorëve në mënyrë elektronike dhe po ashtu drejtorë janë përgjigjur me shkrim dhe gjitha përgjigjet e tyre janë inkorporuar në fund të procesverbalit.

Rasim Fazliu – Ne kemi bërë lëvizjen e pikës pyetjet dhe përgjigje për arsye se në fillim të mbledhjes janë gjithë drejtorët, mirëpo siç po shihet edhe pse e kemi ndërruar pikën e rendit të ditës, drejtorët janë duke vazhduar që të mos jenë prezentë në mbledhje. Po ashtu nuk kam përgjigje në pyetjen që e kam parashtruar se kur do të fillojnë punimet për fazën e dytë për kullimin e tokës në Celinë.

Bahtjar Hoti – Propozoj dhe kërkoj nga kolegët kuvendarë që me një minutë heshtje në nderojmë të rënë në Kumanovë. Me një minutë heshtje janë nderuar të rënë në Kumanovë.

Florije Boshnjaku – Propozoj që familjes së Valon Kabashit ti ndihmohet me një ndihmë financiare.

Rexhep Oruçi – Edhe një herë po e ri potencoj çështjen e stacionit të autobusëve në Rahovec, që një vit jemi duke debatuar rreth kësaj çështje dhe kurrfarë përfundimi akoma nuk kemi marrë. Nuk jam i kënaqur me përgjigjen e drejtorit Fetoshi kur thotë se çështja është pikërisht tek Komisioni i aksionareve. Ne nuk kemi nevojë për shoqërinë aksionare dhe pagesa t'ju bëhet atyre. Propozoj që në mbledhjen e radhës të formohet një komision profesional i cili do ta zgjidhë këtë problematikë.

Nënkryetari – Në bazë të analizës së gjitha akteve ligjore dhe nën ligjore që janë në fuqi e po ashtu të një Udhëzimi që na ka ardhur nga Departamenti për ndërmarrje publike, pjesërisht çështja qëndron ashtu si e thoni ju, por në Ligjin mbi ndërmarrjet publike dhe Udhëzimin administrativ thuhet: “Të gjitha ndërmarrjet publike të cilat ose transformohen në një aksionar 100 % para se të vije tek akti i përgjithshëm, duhet të bëhet auditimi nga auditori i jashtëm”, pra, pa u bërë raporti i këtij auditori nuk mund të vazhdohet ma tutje. Pastaj Kuvendi emëron komisionin e aksionarëve prej 3 anëtarëve i cili vazhdon më tutje në bazë të udhëzimeve të Kuvendit, ku mundet sipas ligjit të emërohet bordi i përkohshëm prej 5 drejtorëve, 4 drejtorë jo menaxhues dhe 1 drejtor menaxhues të cilët emërohen po ashtu nga Kuvendi në afat prej 6 muaj. Pastaj ky bord përgatit statutin dhe akte tjera të brendshme, Kuvendi nxjerr vendim për themelimin e ndërmarrjes publike me aksionarë 100% komuna, dërgohet së bashku me statutin e saj për

regjistrim ku në atë vendim janë të përcaktuara me rregullore se cilat çështje duhet të përmbaj: kapitali fillestar është minimumi 10.000 €, emrat e njerëzve të cilat do të regjistrohen dhe procedura shkon tutje siç është e paracaktuar me ligj. Çështja e stacionit të autobusëve ka mbetur për shkak të pagesës së komisionit. Në ligj shkruan qartë kompensimi i anëtarëve të bordit dhe komitetit të aksionarëve bëhet konform vendimit i cili merret brenda për brenda ndërmarrjes publike, pra nuk caktohet nga Kuvendi por në bazë të situatës financiare.

Kadri Dellova – E përkrahi propozimin që ti ndihmohet materialisht familjes së Valon Kabashit dhe mendoj se të gjithë kuvendarët e PDK ndajnë të njëjtin mendim dhe se shteti do jep atij statusin e merituar. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, që tre vite rruga e Drinit në Krushe të Madhe ka qenë e paraparë të asfaltohet, por sot e 3 vite mbi 2000 banorë të kësaj lagje sidomos fëmijë pësojnë nga neglizhenca e disa njerëzve në komunë. Propozoj që ky Kuvend të formojë një komision 2 ose 3 anëtarësh së bashku me ekspertë të drejtorisë së shërbimeve publike dhe të shihet se pse nuk është duke u ndërtuar kjo rrugë.

Rasim Fazliu – Ne dhe kolegët e mijë e kemi ngritur çështjen rreth pagesës së rrugëtimit të mësimdhënësve. Sa e di komuna ka një marrëveshje me Qeverinë që komuna të heqë shpenzimet e udhëtimit e arsimtarëve. Pyetja ime është sa mësimdhënës udhëtojnë në distancën që duhet të paguhet, dhe sa do të jetë çmimi i kostos nëse i paguajmë udhëtimin atyre. Pyetja tjetër është se në faturat e ujit të pijes janë futur edhe pagesa e rrjetit të kanalizimit, a janë të njoftuar qytetarët rreth kësaj, dhe mos janë futur edhe disa shtëpi që nuk kanë qasje në kanalizimin shtetëror mos i është faturuar edhe atyre.

Azbi Gashi – Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit: a do të ketë kritere për regjistrimin e nxënësve nga shkolla fillore në shkollën e mesme. Po ashtu kam një kërkesë për nënkryetarin, ka ankesa shumë prej nxënësve në stacionin e autobusëve, sepse gjatë ndërrimit të turnit mësimor dhe në mbrëmje po ka përleshje në stacion. A ka mundësi që komuna të bisedojë me policinë që ata gjatë këtyre dy orarëve të patrullojnë më shpesh në stacionin e autobusëve.

Selim Duraku – Kam një pyetje për drejtorin e administratës, zyra e shërbimit civil në Krushë të Madhe ka mungesë të formularëve - certifikata të lindjes dhe ekstrakte.

Fatmir Iska – Të njëjtën pyetje që do e ngris tani e kam ngritur më datën 15 maj, pyetja është për pastrimin e mbeturinave të ngurta në lokacionin qëndresë në Rahovec, e kam potencuar se nuk janë përfillur procedurat e prokurimit lidhur me këtë punë e cila ka filluar dhe ka përfunduar para se të shpallet tenderi dhe para se të nënshkruhet kontrata. Dua një përgjigje nga drejtori për pyetjen të cilën ja ka drejtuar kolegu Rasim për pastrimin e shembjes së dheut në rrugën Fortesë – Celinë. Drejtori ka dhënë përgjigje para se mu nënshkru kontrata asnjë punë nuk mund të bëhet, ndërsa në anën tjetër kryen punë para se të nënshkruhet kontrata. Po ashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike për rrugën “Vëllezërit Haradinaj” e cila është duke u rregulluar në një gjatësi 200 – 300 m pa kanalizim shtetëror. Drejtori thotë se ka arritur një marrëveshje me Selami Shehun i cili ka një kanalizim aty por ai kanalizim është bërë për nevojat e veta e jo për një lagje të tërë. Sipas standardit në një rrugë pusetat duhet të jenë njëra prej tjetrës në lartësi prej 50 m, ndërsa në gjithë këtë distancë prej 300 m nuk kemi asnjë pusëtë.

Përparim Krasniqi – Kërkoj me këmbëngulje që familja e Valon Kabashit të ndihmohet materialisht dhe të mos bëjmë debat tjetër para kësaj pike. Pyetja ime e dytë është problemi me qenë endacak në komunën tonë. Siç e dini kemi pas një rast këto ditë e fundit ku është sulmuar nga qentë endacak një djalë 8 vjeçar. Jam në dijeni se komuna ka ndarë një shumë prej 25.000 € për këtë projekt dhe asgjë deri më tani nuk është vepruar në këtë drejtim. Konsideroj se nuk do të bëhet asgjë deri sa të kafshohen edhe disa fëmijë.

Bahtjar Hoti - Kam pas një takim me kërkesë të kryetarëve të disa fshatrave të sapo zgjedhur, ata e kanë ngritë një shqetësim se janë kryetar jo legjitim përderisa nuk kanë nënshkruar kurrfarë kontrate me askënd dhe nuk ju është kërkuar kurrfarë e dhënë personale e tyre. Pyetja tjetër është në lidhje me ish ambulanten e vjetër në Ratkoc, kemi dëgjuar se administrata ka marr vendim që të ndërtoj zyre të vendit. Unë mendoj se aty është vendi ideal për të ndërtuar një park pasi është në qendër të fshatit.

Nënkryetari – Sa i përket ligjimitetit të kryetarëve të fshatrave nuk kemi çka të bisedojmë pasi ata janë zgjedhur me votën e fshehtë nga të pranishmit të cilët kanë qenë në mbledhje. Unë nuk pajtohem me kolegun tim Rasimin kur thotë se nuk e dorëzojmë raportin në lidhje me përzgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave, sa i përket pagesave ky kuvend ka marr vendim për tu paguar anëtarët e komisionit dhe po ashtu ky kuvend do ta zgjidh këtë problem, ndërsa emrat e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave medoemos duhet të dorëzohen për arsye se ne duhet ta fuqizojmë rregulloren të cilën e kemi aprovuar në kuvend dhe në bazë të procesverbaleve që janë mbajtur në çdo fshat të lëshohet vendim për secilin se me sa vota ka ardhur dhe të lëshohet vendimi për secilin për mandatin i cili shkruan në rregullore sa është, ndërsa detyrat dhe kompetencat e tyre janë të përshkruara në rregullore.

Rasim Fazliu - Në web faqen e komunës janë të dhënat e kryetarëve të fshatrave, pra emrat e tyre dhe të gjitha të dhënat e tyre, kurse raportin e punës unë e thash se nuk e dorëzoj deri sa nuk bëhet pagesa sepse është bërë një mund shumë i madh.

Kryesuesi - Unë kam pas një bisedë me ministrin e financave, është keqkuptuar ajo qarkore që ju është dërguar drejtorëve pagesat për këshilltar nëpër komisione nuk bëhen për shërbyes civilë të cilët janë në orare të punës, por pagesa bëhet për shërbyes civil që punojnë jashtë orarit të punës nëpër komisione të caktuara. I nderuar Rasim pagesa

nuk bëhet pa u bërë raportimi në kuvend dhe pa e sjell lista e pjesëmarrësve të komisionit në sa takime keni mare pjesë, pastaj bëhet pagesa e komisionit.

Besnik Hoti – Pyetja ime e parë është për nënkryetarin, dua ta di se në shtëpinë e kulturës në Ratkoc a ka të punësuar dhe nëse është pse nuk del në vend të punës. Pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike, si mund të planifikohet ndërtimi i një mini parku afër qendrës në Ratkoc pa u konsultuar me asnjë strukturë të fshatit. Ky mini park është duke u bërë për izolimin e disa dhe favorizimin e disa bizneseve tjera, pres përgjigje nga ana e drejtorit.

Rukije Krasniqi – Sa është ligjore dhe etike që zyrtarja komunale Habibe Haxhimustafa të hyjë në projekt me bashkëfinancim me komunën duke fituar projektin me vlerë 20.000 € kur dihet se në komunën tonë ka mjaftë OJQ dhe kemi mundur t'i ndihmojmë atyre. Pyetja e dytë është se kam kërkuar me 5 maj 2015 një listë të pagesave nga janari deri në muajin prill dhe i kam harmonizuar me pjesëmarrjen e këshilltarëve komunal. Në muajin shkurt kanë munguar 7 këshilltarë të kuvendit komunal, në mars 2 këshilltarë. Prej këtyre 9 këshilltarëve komunal nuk janë paguar 4, ndërsa 5 këshilltarët e tjerë janë paguar. Dua ta di pse është kjo laramani e pagesave diku po e diku jo.

Kryesuesi – Nëse jeni të gjithë të mendimit se marrje e lejes që mos të jeni prezentë në seancën e kuvendit duhet të paguhet ne do e paguajmë, por ju e keni keqkuptuar se nuk do të thotë nëse dikush merr leje të mos jetë në Kuvend do e merr edhe mëditjen por arsyetohet sepse me ligje thuhet se nëse një delegat nuk merr pjesë në 6 seanca në kuvend atëherë e humb të drejtën e mandatit.

Xhihad Vuçitërna – Kam një pyetje për drejtorin e kulturës, është bërë një kërkesë nga zyrtarët e auto klubit Rahoveci për ndihmë financiare për kuotizim dhe për mbarrëvajtjen e garave për këtë sezon. Dua ta di se kjo drejtori a e ka mare parasysh këtë kërkesë për përkrahje të këtij auto klubi sepse është auto klubi i parë në komunën tonë që është formuar dhe a mundemi ne si asamble komunale të bëjmë diçka për këtë auto klub.

Sinan Bajraktari – Së pari dua të ndërlidhem me diskutimin e Bahtjarit, sa i përket kryetarit të fshatit Polluzhë ai është legjitim, ai ka marr pjesë edhe në mbledhjen e parë që i ka ftuar kryetari, po ashtu merr pjesë edhe në trajnimet që janë duke i vazhduar kryetarët e fshatrave. Kam një pyetje, pse nuk po lëshohet në punë ambulanca në fshatin Polluzhë. Pyetja dytë është për drejtorin e shërbimeve publike, kanalizimi në fshatin Polluzhë operatori nuk i ka kryer të gjitha punët, ndërsa premtimet kanë qenë nga ana e operatorit që punët e mbetura të kryhen në pranverën e 2015.

Bahtjar Hoti – Sinan nuk e ke kuptuar drejtë atë që kam thënë, e tha Rasimi se ata edhe në web faqe i ke si kryetar, por kërkesa e tyre ka qenë që ata ta kenë një vendim që janë legjitim si kryetar të fshatrave.

Ejup Kabashi – Dua ta sqaroj çështjen e Valonit, Valon Kabashi ka qenë një djalë i ri nuk ka pas pretendime të cilat janë duke u spekuluar, i gjithë frymëzimi i tij ka qenë fryma kombëtare dhe absolut të mirat materiale. Për ne ai është dëshmor, ne e dimë se versioni zyrtar do të del dhe me kalimin e kohës do të bindemi se ata janë dëshmorë të pakontestueshëm. Kam një kërkesë nga institucionet e tona që mos ti neglizhojnë dëshmorët së paku ti nderojmë pra të mos kemi frikë nga dëshmorët tanë.

Kryesuesi – E kemi një propozim nga disa këshilltarë për ndihmë financiare familjes së Valon Kabashit të vvarë në Kumanovë. Nuk e di se si është gjendja me buxhet, por kisha kërkuar nga ju që edhe nëse marrim vendim për ti ndihmuar familjes së Valonit t'i lejmë mundësitë Kryetarit që të vendos për shumën të cilën ka mundësi t'i ndajë. E qesë në votim propozimin me këtë konkludim që e thash. Kush është për aprovimin e këtij propozimi: Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar ky propozim. Një sqarim çështjen e pyetjeve dhe përgjigjeve në pyetjet e këshilltarëve ne e kemi të rregulluar me rregulloren e punës së Kuvendit dhe është e radhitur në pikën e fundit dhe nga mbledhja e ardhshme prapë kjo pikë do jetë si pikë e fundit, kërkoj mirëkuptim nga ana juaj.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën Janar-Mars 2015.

Lulzim Sylejmani – Praktikë e mirë është që çdo 3 muaj ta kemi një raport për shpenzime të buxhetit. Në KPF është kërkuar që shpenzimet të jenë të ndara për drejtorin, por unë edhe në KPF ju kam treguar se kemi problem me regjeneruar raporte të detajuara për 3 mujorin e parë për shkak të kalimit të sistemit SMFK-së në versionin e 7 dhe nuk e rigjeneron raportin ndarës, por në raportin e 6 mujorit do ta keni. Sa i përket raportit të obligimeve që e kanë projektet në vazhdim në faqen 10 e keni në fund të kolonës ku i specifikojnë të gjitha borxhet e secilës kontratë veç e veç. Ndërsa sa i përket raportit financiar të të hyrave vetanake për këtë periudhë kemi një realizim prej 196,049.38 € ku planifikimi ka qenë për të njëjtën periudhë 274,753.00 €, pra jemi larg realizimit, por për mosrealizim ka ndikuar ligji i cili pritet të hyjë në fuqi për faljen e borxheve deri në fund të 2008. Shpresoj se pas miratimit të ligjit të hyrat vetanake do të rriten, sepse qytetarët do të kushtëzohen me pagesën retroaktive nga 2009 e këndeje. Ndërsa të hyrat e tatimit në pronë qëndrojmë mirë në 3 mujorin e parë. Unë personalisht nuk jam o kënaqur duke pas parasysh fluksin e qytetarëve për aplikimin në drejtorinë e bujqësisë. Sa i përket raportit 3 mujor të shpenzimit të buxhetit në tërësi pagat dhe mëditjet janë shpenzuar në vlerë 24 %, mallrat dhe shërbimet në vlerë 15 % kjo përqindje e vogël është për shkak të sistemit që kemi pas probleme dhe nuk kemi mundur të bëjmë pagesat. Tek subvencionet në muajin e 2 dhe 3 nuk ka pas shpenzime për atë arsye është kjo vlerë kaq pak e shfrytëzuar, sidomos tash në subvencionet që janë në shëndetësi diku rreth 60 % e vlerës është shpenzuar në ndihma në shëndetësi. Po ashtu edhe me aprovimin e marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve të varrimit i kemi paguar 3 fatura nga subvencionet e zyrës së Kryetarit që është vlera rreth 15.000 €. Tek investimet kapitale janë paguar mjetet rreth 750,000.00 € për shkak se pagesat janë

kryer vetëm në muajin e 3, në muajin parë dhe të dytë nuk janë kryer. Sa i përket kontratave dhe raportin që e kemi marr nga zyra e prokurimit për kontratat aktive, ju e keni në raporte dhe në këto raportime jeni duke e parë se ne jemi ende duke u përball me kontratat e vitit 2013 ku kapin vlerat milionëshe dhe këto kontrata jemi duke i respektuar edhe gjatë buxhetit të vitit 2015 por do i respektojmë edhe një pjesë në buxhetin e vitit 2016 sepse kompanitë ose kanë kryer punët ose janë duke kryer punët. Vlera e mbetur sipas kontratave të vitit 2013 është afër 2.3 milion. Besoj se gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2016 do të jemi më dorë lirë që ti respektojmë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në çdo lokalitet ku ka nevojë për investime. Dhe në fund siç jeni duke i para i kam pasqyruar obligimet që kanë qenë me 31.12.2014 dhe obligimet të cilët ne jemi të detyruar që ti dërgojmë çdo fund muaji në thesar dhe obligimet e faturave 31.03.2015.

Florije Boshnjaku – Tek faqja 4 ku thuhet realizimi për periudhën raportuese është pa të hyrat prej gjobave të trafikut dhe gjykatave, ndërsa në faqen numër 5 kemi gjobat në trafik për 2015. Nuk e kam të qartë këtë, mos është ndonjë gabim. Faqe 13 tek lidhja e kontratave, datat kur janë nënshkruar kontratat, raporti që na është sjellë neve është deri me 31 mars të vitit 2015, ndërsa ka kontrata që janë nënshkruar edhe pas muajit mars. Te paraqitja e obligimeve mua më intereson për mallrat dhe shërbimet obligimet e faturuara deri me 31.12.2014 janë përafërsisht 80,000.00 € ndërsa obligimet e faturuara deri me 31.03.2015 janë 92,000.00. A janë 80,000.00 plus 92,000.00 se nuk jam duke e kuptuar, deri sa në mallra dhe shërbime ke para të lira edhe 550,000.00 €. Njëjtë kemi edhe tek shpenzimet në komunalitet deri 31.12.2014 kemi 49,000.00 € ndërsa deri me 31.03.2015 kemi vetëm 1.000 €.

Përparim Krasniqi – Këtij raporti 3 muajorë së pari i mungon periudha krahasuese e vitit të kaluar dhe raporti i secilës drejtori për mallra dhe shërbime, pra është një raport e mangët, po drejtori e arsyetoj se është për shkak sistemit. Tek faqja 13 asnjë pagesë nuk është bërë nga kontratat e lidhura për 5 muajt e parë 2015, ndërsa në faqen e fundit shkruan për investimet kapitale janë shpenzuar 311,000.00 € dua një përgjigje nga drejtori. Obligimet e faturuara për një vit janë 79,000.00 € ndërsa për 3 muaj 92,000.00 € është një dallim shumë i madh edhe për këtë dua një sqarim. Qeveria komunale a i është përmbajtur planit të prokurimit që është në KRPP kontratat publike që duhet të shpallen në bazë të afatit të caktuar.

Azbi Gashi – Te faqja numër 13 tek lidhja e kontratës që është bërë me shumën 120,000.00 € arsyetimi është i mangët sepse këtu thuhet vetëm hartimi i projekteve të ndryshme në komunën e Rahovecit, pra nuk ka detaje ma tepër se për çka është lidhur kjo kontratë.

Arsim Kastrati – Tek investimet kapitale ndërtimi i zyrës së vendit në fshatin Drenoc thuhet faza e dytë, mbetje kanë mbetur diku 1,699.50 €. Më intereson se a është i kryer ky projekt apo është në vazhdim, sepse unë para disa dite kam qenë aty dhe ai objekt është në gjendje të mjerueshme.

Rasim Fazliu – Tek faqja 3 është dashur të shkruhet: qëllimi i këtij raporti financiar 3 muajor është që ta njoftoj Kryetarin, Kuvendin dhe KPF e jo vetëm kryetarin.

Rukije Krasniqi – Te përshkrimi i kontratës kodit 113 fasadimi i objekteve të banimit në Rahovec vazhdim, a do të përfshij vetëm fasadimin e këtyre objekteve apo edhe rregullimi i oxhaqeve dhe kulmeve.

Lulzim Sylejmani – Projekti për fasadimin e objekteve është bërë në mandatin e kaluar dhe ne jemi duke e zbatuar ashtu si është bërë. Pyetjet për çështjet e obligimeve që i kam deklaruar në faqen 14, këto janë faturat të 31.12.2009, fatura që i ka gjetë data 31 në fund të vitit dhe gjatë shkurtit dhe marsit, sigurisht këto fatura janë pranuar dhe obligimi më 31.03.2015 ka qenë kjo gjendje që është në kolonën e fundit. Po ashtu kjo nuk kishte me qenë me këto vlera sikurse të na kishte punuar sistemi në mars, sepse tani kemi pagesa të rregullta. Sa i përket raportit të kontratave në 2015 unë i kam raportuar ashtu si mi kanë sjellë zyra e prokurimit dhe vetëm një kontratë është lidhur me 31 mars, ndërsa të tjerat janë të gjitha në muajin prill dhe maj. Për këto dy muaj nuk kemi pas si të raportojmë në këtë raport sepse janë kontrata vetëm sa janë lidhur dhe unë qëllimisht i kam futur të gjitha që janë aktive deri me sot. Ndërsa tek pyetja e Arsimit për zyrën e vendit ajo pjesë që është e pa paguar është pjesa e garancisë. Tek hartimi i projekteve që pyeti Azbiu është një kontratë pra varësisht prej projekteve, nuk ka vlerë sa mundem me pagua, pra vlera si vlerë është vetëm e kontratës por nuk është shpenzim që mundet të jetë aq. Pyetja se kur fillon plani i prokurimit, plani i prokurimit fillon në muajin mars dhe vazhdon deri në muajin tetor.

Kadri Dellova – Dua një shpjegim nga drejtori faqe 13 raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike, mirëmbajtja e parqeve, varrezave të dëshmorëve dhe varrezave në komunën e Rahovecit, dua ta di se kjo kompani a e ka vetëm mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve apo edhe ato publike.

Lulzim Sylejmani – Mirëmbajtja e varrezave publike janë për disa qendra si në Rahovec, Ratkoc, Krushe të Madhe dhe Xërxë, kjo ka qenë mundësia buxhetore e komunës.

Kadri Dellova – Kam një propozim që në mbledhjen e ardhshme të na vijë lista e tatimit në pronë për vitin 2014 dhe 6 muajorin e 2015 për çdo lokalitet dhe të shohim se kush paguan ma tepër.

Lulzim Sylejmani – Kjo nuk është aspak problem mundem t'ju sjell, po ashtu kam edhe një informatë për ju Kadri se punimet për rrugën e Drinit do të fillojnë këtë javë.

Kryesuesi – Falënderoj drejtorin për raportin që ja ka ofruar kuvendit dhe për përgjigjet që i dha, kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i projekt Vendimit për formimin e Komisionit ad – hoc për Shqyrtimin e ankesave të studentëve për bursa.

Kryesuesi - siç e dini ky komision është formuar në mbledhjen e fundit, mirëpo është bërë shkelja e rregullore për ndarje të bursave për shkak se me rregullore thuhet se komisioni ad – hoc formohet prej 5 anëtarëve, 2 nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile, ndërsa ne i kemi bërë vetëm 3 nga ana e kuvendit, nga ekzekutivi pajtohen që të jenë 3 nga kuvendi dhe 1 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile, a pajtoheni edhe ju si kuvendar me këtë propozim, nga ekzekutivi nënkryetari e propozon Shemsije Deliu, prej shoqatave të dala nga lufta Nazmi Bellaqa. E qesë në aprovim komisionin ad - hoc: me 1 kundër dhe 1 abstenim është aprovuar vendimi për komisionin ad – hoc.

Florije Boshnjaku – Kam një propozim që të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës që të obligohen anëtarët e komisionit që ta dorëzojnë raportin në afat të caktuar për raportim në Kuvend.

Kryesuesi - Patjetër që duhet që të raportojnë në Kuvend nëse jo nuk do ti bëhet pagesa e mëditjeve.

5. Propozimi i anëtarëve për formimin e komiteteve jo obligative.

Kryesuesi - Edhe kjo pikë është shqyrtuar dhe trajtuar në KPF, jemi dakorduar që të formohen 4 komitete jo obligative, 1. Komiteti për zhvillim ekonomik, Mbrojtje të ambientit dhe Bujqësi, 2. Komiteti për Urbanizëm, Gjeodezi, pronë dhe Inspeksion, 3. Komiteti për arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, 4. Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe barazi gjinore, këto komitete jemi dakorduar që të kenë nga 5 anëtarë dhe duhet të janë anëtarë nga Kuvendi i komunës, ndërsa vendimet bëhen veç e veç për secilin komitet, ku do të parashihen detyrat dhe përgjegjësit të anëtarëve të komiteteve gjegjëse. Kërkoj nga ju kuvendar të nderuar që ti propozoni emrat për komitet në fjalë:

1. Komiteti për zhvillim ekonomik, Mbrojtje të ambientit dhe Bujqësi: nga PDK-ja Elvedina Cana, nga LDK-ja e propozojmë Selim Duraku, nga AAK-ja i kemi dy anëtarë: Afrim Limani dhe Artan Zanuni, nga LB-ja Bahtjar Hoti.

2. Komiteti për Urbanizëm, Gjeodezi, pronë dhe Inspeksion: PDK-ja i ka dy anëtar, Beatrisa Demiri dhe Astrit Thaqi, nga LDK-ja Arsim Kastrati, nga LVV Minavere Hoti, nga AAK-ja Besnik Hoti.

3. Komiteti për arsim, Kulturë, Rini dhe Sport: Nga PDK-ja Kadri Dellova, nga LDK-ja Sinan Bajraktari dhe Mirjeta Krasniqi, nga radhët e AAK-së Rukije Krasniqi, nga LVV Azbi Gashi.

4. Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe barazi gjinore: Nga PDK-ja Erlira Mullabazi dhe Floride Bajraktari- Krasniqi, nga LDK Luljete Kadiri, Nga AAK-ja Qëndresa Kryeziu, nga radhët e PD Xhihad Vuçitërna.


E qesë në aprovim të gjitha komitetet jo obligative : Konstatohet që në mënyrë unanime janë aprovuar të gjitha komitetet jo obligative.

Azbi Gashi - Kam një propozim mbase që pas nxjerrjes së vendimeve të gjitha anëtarëve të komitetit ti dorëzohet nga një vendim.


Faleminderit për pjesëmarrje në këtë mbledhje, shihemi në mbledhje tjera.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12.35.

Procesmbajtësi,
Fahredin Sharku



Kryesuesi
Nahit Elshani

-III- Nr. i prot. 415 Më 28.05.2015
Br. prot. Dt. 28.05.2015
ORAOVEC - ORAHOVAC